

RELACIONI ARKITEKTONIK I PROJEKTIT

OBJEKTI:

SHETITORJA REPUBLIKA



ADRESA: Bulevardi "Republika", Patos.

1. Vendndodhja

Zona qe do te ndertohet Shetitorja ndodhet pergjate Bulevardit "Republika" te qytetit te Patosit.

Pjesa e kesaj siperfaqe, saktesisht 3.25 ha , eshte konceptuar, projektuar dhe detajuar per shetitore publike.

2. Pershkrimi i situates ekzistuese

Zona e propozuar per zhvillim eshte nje e tere dhe eshte siperfaqe publike ne pjesen me te madhe, por perfshin edhe disa objekte me pronesi private.

Ajo kufizohet ne pjesen veriore nga Lagja "1 Maj", ne pjesen Jugore nga Lagja "E Re" dhe ne pjesen Veri-Lindore nga Lagja "Naftetari". ne te gjithë gjatesine e saj siperfaqja e menduar per Shetitoren perfundon tek pallatet rrethues.

Situata aktuale e kesaj siperfaqe eshte ne nje gjendje shume pak te prekur, me nevoja per nderhyrje si ne trotuaret, lulishtet, por edhe ne rruge me ane te riveshjes

3. Pershkrimi i konceptit te nderhyrjes urbane.

Ky studim ka pasur si qellim rehabilitimin dhe rivitalizimin e kesaj zone duke e bere te frekuentueshme dhe funksionale sipas kerkesave qe kjo zone mbart.

Projekti deri ne arrijten e konceptit baze te kompozimit urbanistik dhe arkitektonik ka marre parasysh kriteret e percaktuara nga rregullorja e urbanistikes.

Ky koncept konsiston ne ndarjen ne 3 pjese te kesaj siperfaqje:

1. Hapesire publike "lulishte"
2. Rruga e Bulevardit Republika
3. Trotuaret rrethues te rruges

Ky koncept nderhyrjeje ndihmon ne menyre te plotesuar kedo qe ka per qellim dhe arsye per t'u afruar kesaj zone.

Duke patur parasysh formen e siperfaqes eshte gjetur nje forme e sistemimeve dhe zonimeve qe te orientohet nga pikat kryesore qe shihet kjo zone.

4. Pershkrimi i projektit arkitektonik.

Duke qene si objekt per sherbime publike ne dobi te qytetareve, sherbimet ndaj tyre jane te menduara edhe per menyren sesi do te shfrytezohen. Per kete eshte menduar nderhyrja ne cdo sheshe pallati dhe trotuar duke e rehabilituar ate. Eshte menduar alternimi i siperfaqeve te gjelberta me siperfaqet me beton te stampuar si dhe trotuaret me pllaka guri. Eshte menduar te kete edhe nderhyrje ne siperfaqen e rruges duke e riveshur ate me nje shtres tapeti si edhe ne kuneta duke i riparuar ato dhe duke i hedhur nje shtrese per te bere riveshjen e tyre. Ambjentet do te perdoren nga te gjitha grupmoshat, duke filluar qe nga femijet e deri tek te moshuarit. Ambjenti do perdoret per shplodhje dhe per te kaluar kohen e lire. Siperfaqja e rruges do te kryej te njejtin funksion.

Eshte menduar qe te gjitha keto funksione dhe hapësira te zhvillohen ne nivele te ndryshme. I gjithe objekti eshte ndare ne 4 zona te ndryshme (A - D) Secili nivel i eshte nenshtuar nje mobilimi urban me shumllojshmeri materialesh dhe diversitet ngjyrash. Nivelet perkojne me te njejtin stil mobilimi dhe grafike ku dyshemeja eshte e shtruar me lluster betoni te stampuar. Jane krijuar zona me mbjellje lulesh shumengjyreshe dhe krijimi i disa vazove qe sherbejne si stola ulese duke patur nje peme ne qender. Stolat qe do te vendosen jane kompozuar ne nje menyre qe te japin pershtypje si ambjente me vete. Eshte menduar nderhyrja per veshje zbukuruese edhe e mureve mbajtes te trotuarit duke i dhene nje pamje me te bukur.



Ngjyrat e perdorura jepen nepermjet materialeve te perdorura por edhe lysterje, per evidentimin edhe te funksioneve qe orfrohen ne kete lulishte.



Gjelberimi i perdorur eshte i shumllojshem nga bari dekorues tek ligustrat, nga bimet kacavjerrese tek mimozat, nga pemet gjethe mbajtese dhe gjetherenese tek lulet shumegjyreshe.

open
Procurement
Albania